



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborui Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.129/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Afijete Sada-Glllogjani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Graçanicë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 02.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e organizatës Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lista Serbe me seli në Graçanicë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 6,100.00 (gjashtëmijë e njëqind) euro, të cilën i njëjti detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Urdhërohet subjekti politik Lista Serbe me seli në Graçanicë, që brenda afatit prej 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi, që ta përmirësoj shkeljet e përcaktuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i .

A r s y e t i m

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë: 29.09.2019, me të cilën pretendon se në komunën e Graçanicës, në disa rrugë të ndryshme si në rrugët: Branka Qopiqa, Vozhde Karagjorgje dhe Simonidina janë vërejtur posterët e subjektit politik: Lista Serbe, të cilat janë ngjitur në shtylla elektrike, në pritore (stacion) të autobusëve, në trafo stacione të energjisë elektrike dhe mbrapa shenjave të komunikacionit publik. Paraqitësi i ankesës thekson se me këto veprime subjekti politik Lista Serbe ka shkelur nenin 33 paragrafi 1 pika b) të LZP-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore, ankuesi ka bashkangjitur në cilësi të provave: disa fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

PZAP-i me datën 29.09.2019 e njoftoi subjektin politik Lista Serbe me ankesën e parashtruar dhe kërkoi nga e njëjta që deri me datën 30.09.2019 të përgjigjet në ankesë.

Përkundër kërkesës së bërë subjekti politik Lista Serbe nuk ofroi asnjë përgjigje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se subjekti politik i ka vendosur posteret e ndryshëm në shtyllat e ndryshme elektrike, në trafo stacione dhe në kabina të stacioneve të autobusëve, vende këto të ndaluara me ligj dhe se veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakatave dhe posterave, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut etj*”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik kanë qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, sepse ka marr pjesë në zgjedhjet e mëhershme;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret, duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lista Serbe, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, po ashtu si rrethanë tjetër, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t’u përgjigjur, por e njëjta nuk ka ofruar ndonjë përgjigje dhe nuk kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, veprim ky i cili ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Me anë të këtij vendimi respektivisht gjobës së shqiptuar paneli synon të ndikon te subjekti politik që në të ardhmen ky subjekt mos t’i përsërit veprimet e njëjta apo veprime tjera të cilat bien ndesh me ligjin.

Në raport me pikën II të dispozitivit të vendimit, Paneli vendosi që konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së, të urdhëron subjektin politik Lista Serbe që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljen në afatin prej 24 orëve, ndërsa në të kundërtën nëse nuk vepron sipas urdhrat të

panelit do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i , në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr. 129/2019 më datën 02.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



***Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*